



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGJETIKES  
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGTARE

URDHER

Nr. 991/Date 14.12.2007

PËR NDRYSHIME NE STATUTIN E SHOQERISE ANONIME  
“ UJESJELLES - KANALIZIME” KRUJE SH.A

Ne mbështetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutës te Republikës se Shqipërisë, te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 “ Për disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore ne shoqëri tregtare” ndryshuar me Dekretin Nr. 1195 date 14.08.1995, Ligjin Nr 8158, date 07.11.1996, ndryshuar me Dekretin Nr. 3318, date 30.04.2002, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, VKM 678, date 03.10.2007 dhe nenit 128 te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare”, me cilësinë e aksionerit te vetëm

URDHEROJ :

1.Ndryshimin e statutit te shoqerise “Ujesjelles - Kanalizime” Krujë, sh.a si me poshte:

Neni 7, pika 3 ndryshon si me poshte:

Aksionet zotërohen ne masen 80.9 % nga Bashkia Kruje dhe 19.1 % nga Komuna Cudhi, si perfaqesues te pronarit. Kjo e drejte ju kalohet me vendimin nr. 660 date 12.9.2007 “Për transferimin e aksioneve te shoqërive te ujesjellesve dhe kanalizimeve njesive te qeverisjes vendore”.

2.Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Tregtare për kryerjen e veprimeve përkatëse ne përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit” Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32, 36.

Ky Urdhër hyn ne fuqi menjëherë.



MINISTRI

GENC RULI

VENDIM

Nr 51 Datë 31.08.2015

Për

Miratimin e ndryshimit të aksionerëve të Ndërmarrjes së Ujësjetllës-Kanalizime sh.a. Krujë nga Bashkia e qytetit Krujë dhe Komuna Cudhi, në Bashkinë Krujë dhe autorizimin e Z. Artur Bushi për të përfaqësuar Këshillin e Bashkisë Krujë në Asamblenë e Aksionerëve të Ndërmarrjes së Ujësjetllës- Kanalizime sh.a. Krujë.

Këshilli i Bashkisë Krujë, në mbledhjen e tij të datës 31.08.2015, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, mbështetur në ligjin 8652 të datës 31.07.2000 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore" i ndryshuar neni 32, ligji nr 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar :

VENDOSI

1. Të Miratimin e ndryshimit të aksionerëve të Ndërmarrjes së Ujësjetllës-Kanalizime sh.a. Krujë dhe kalimit të aksioneve nga Bashkia e qytetit Krujë me 80.90% të aksioneve dhe Komuna Cudhi me 19.10 të aksioneve, në Bashkinë Krujë me 100% të aksioneve të NUKK
2. Të miratojë autorizimin e Z. Artur Bushi për të përfaqësuar Këshillin e Bashkisë Krujë në Asamblenë e Aksionerëve të Ndërmarrjes së Ujësjetllës- Kanalizime sh.a. Krujë
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit për bazueshmëri ligjore nga Prefekti i Qarkut të Durrësit.

Kryetari i Këshillit

Hysni Caca



Adresa: Qender Kruje, Tel./Fax 00355 511 23373 e-mail bashkiakruje@yahoo.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Durrës, më 18.09.2015

Nr. 1655/11 prot.

Lenda: Verifikim i ligjshmerise se aktit

Drejtuar : Z.Hysni Caca

Kryetar i Keshillit Bashkiak Kruje

Verifikova ligjshmerine e Vendimit te Keshillit Bashkiak Kruje Nr. 51 date 31.08.2015 "Per miratimin e ndryshimit te aksionereve te Ndermarjes se UKK Sh.a ... dhe autorizimin e Z. Artur Bushi per te perfaqesuar Keshillin e Bashkise Kruje ne Asamblene e aksionereve te Ndermarjes se UK sh.a Kruje"

E gjej ate te bazuar ne ligj dhe baze te kompetencave qe me jep Ligji Nr.8927 dt.25.07.2002 "Per Prefektin", e konfirmoj bazueshmerine ligjore te tij.

Ju falenderoj per bashkepunimin.

PREFEKTI

Rolant XHEJLAJ

